

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-228/2015**

**Prishtinë,  
25 Prill 2018**

Në çështjen juridike të:

**R. N., në emër të të atit të ndjerë L. N.**

**Pala ankuese**

kundër

**N/A**

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit, Krassimir Mazgalov dhe Ragip Namani, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/260/2014 të datës 21 Tetor 2014 (lënda e regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronës me numër KPA38601), pas shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 25 Prill 2018, mori këtë

## AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e paraqitur nga R. N, e regjistruar me numrin GSK-KPA-A-228/2015, kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/260/2014 sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrat KPA38601.
2. Vërtetohet vendimi i KKPK-së KPCC/D/A/260/2014 i datës 21 tetor 2014 sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA38601

### Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 28 Maj 2007, R. N. (më tutje: Pala Ankuese) ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës ( më tutje: AKP) duke kërkuar ri-posedimin e ngastrës kadastrale numër 119/10, arë dhe kullosë me sipërfaqe prej 08.95.58 ha, e cila ndodhet në zonën kadastrale Vrellë/Vrelo, Komuna e Lipjanit (më tutje: prona e kërkuar). Ai deklaroi se babai i tij e kishte fituar pronësinë mbi pronat e kërkuara përmes anulimit të kontratës së blerjes të lidhur ne vitin 1964 mes të ndjerit dhe Kooperativës Bujqësore. Ai pohon se prona ndodhet në afërsi të Aeroportit Ndërkombëtarë të Prishtinës dhe një pjesë brenda Aeroportit kurse humbja e posedimit ishte si rezultat i rrethanave të periudhës 1998/1999 në Kosovë.
2. Për ta mbështetur kërkesën e tij, Pala Ankuese dorëzoi në AKP dokumentet në vijim:
  - Aktgjykim i Gjykatës Komunale në Lipjan P.Br.541/92 i datës 20 Korrik 1993 me të cilin palës ankuese i kthehej në posedim dhe pronësi prona e kërkuar,
  - Aktgjykim i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë GŽ.br. 765/93 i datës 29 Tetor 1993 me të cilin ndryshohej Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Lipjan P.Br.541/92 i datës 20 Korrik 1993 vetëm në pjesën e kthimit të çmimit blerës të palës ankuese kurse në pjesët tjera ai konfirmohej,
  - Kopje e kontratës së qirasë Nr.75 datë 31 Mars 1994 mes ndërmarrjes “Poljoprivreda” dhe palës ankuese mbi dhënien me qira të pronës së kërkuar,
  - Kopje të Autorizimit ku L.N. autorizon R. N. që ta përfaqësoj. Autorizimi ishte vërtetuar në Gjykatën Komunale të Kraljevës me 1 Korrik 2001 me numër Ov. Br.3124/2,

- Certifikatë vdekje e lëshuar nga Komuna e Krlevës me 6 Shtator 2006 me të cilin dëshmohet se i ati i palës ankuese L. N. kishte ndërruar jetë me 21 Gusht 2006 në Krlevë/Kraljevo .
  - Kërkesë e palës ankuese drejtuar Kadastrit të Komunës së Lipjanit me datë 9 Shkurt 2012 për dhënien e Fletës Poseduese mbi bazën e Aktgjykimit të formës së prerë,
  - Aktvendim i Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër i Komunës së Lipjanit Nr. 9-464-659 protokoll 139/2011 i datës 30 mars 2012 me të cilin refuzohej kërkesa e R. N.
3. Identifikimi i Kërkesës u bë më 8 Shkurt 2008. Më 24 Shtator 2010 u publikua kërkesa në Gazetën e Njoftimeve nr.3 të AKP-së dhe në Listën e Zyrës për Prona të UNHCR-së. Gazeta dhe lista u lanë te prijësi i fshatit i cili pranoi që ta lë atë në dispozicion të palëve të interesuara si dhe në Gjykatën Komunale të Lipjanit, në Zyrën Rajonale të AKP-së në Prishtinë. Gjithashtu, Lista dhe Gazeta u shpërndanë në Zyrën Kryesore të UNHCR-së, te Ombudspersoni, të Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK).
  4. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së kishte gjetur certifikatën e pronësisë sipas detyrës zyrtare ku ngastra kadastrale 119/10 ishte e regjistruar si pronë shoqërore në emër të Kooperativës Bujqësore e cila i ishte nënshtruar procesit të privatizimit përmes Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit-tani Privatizimit. Ngastra pjesërisht ishte në Shfrytëzim të Aeroportit të Prishtinës.
  5. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së i kishte drejtuar kërkesë Agjencisë Kosovare të Privatizimit duke kërkuar informacion lidhur me statusin e pronës së kërkuar. Me datë 24 Shkurt 2014 Agjencia Kosovare e Privatizimit iu përgjigj AKP-së duke e informuar se prona e kërkuar evidentohet si pasuri shoqërore e Ndërnarrjes Bujqësore “Kosova” nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Ndërnarrja Bujqësore “Kosova” ishte në proces të likuidimit.
  6. Më 18 qershor 2014, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës e hodhi poshtë kërkesën përmes Vendimit të tij KPCC/D/A/260/2014 të datës 21 tetor 2014. Në paragrafët 19 dhe 20 të Vendimit Grupor, që sipas vendimit të vërtetuar zbatohet veçanërisht për kërkesën në fjalë, thuhet se prona e kërkuar ishte vendosur nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (dhe më pas nën pasardhësen e saj Agjencia Kosovare e Privatizimit) në bazë të Rregullorës së UNMIK-ut 2002/12 e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2005/18 dhe se Ndërmarrja Shoqërore ishte në procesin e likuidimit, prandaj prona e kërkuar bie ekskluzivisht nën juridiksionin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës sipas

nenit 4.1 (c) dhe nenit 5.1 (a) të Rregullores së UNMIK-ut për Dhomën e Posaçme 2008/4. Në këto rrethana, Komisioni konstaton se bartësi i pretenduar i të drejtës pronësore nuk e ka humbur aftësinë për ta ushtruar të drejtën e tij mbi pronën si rezultat i konfliktit në vitet 1998-1999, por si rezultat i procesit pasues të privatizimit. Rrjedhimisht, kërkesa bie jashtë juridiksionit të komisionit.

7. Vendimi iu dorëzua palës ankuese më 18 shkurt 2015. Ajo paraqiti ankesë më 6 Mars 2015.

### **Pretendimet e palës ankuese**

8. Pala ankuese deklaron se vendimi i KKPK-së përmban shkelje thelbësore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe procedurale, si dhe vërtetim të gabuar të fakteve. Ai pretendon se prona ishte marr nga Ndërmarrja Shoqërore në vitin 1964 nën presion dhe se kontrata si e tillë ishte nuluar në vitin 1993 pas vlerësimit të Gjykatës se Kontrata ishte e kundërshtim me ligjet e atëhershme.
9. Pala ankuese pretendon se ajo e fitoi të drejtat pronësore mbi sipas Aktgjykimit të gjykatës Komunale në Lipjan. Pala ankuese deklaroi se në regjistrat kadastral prona është e evidentuar si pronësi e babait të tij.
10. Pala ankuese nënvizon se Komisioni veprroi në kundërshtim me obligimin e tij ligjor duke mos arritur të përcaktojë se kush e kishte shfrytëzuar pronën e kërkuar para konfliktit 1998/1999. Po ashtu, pala ankuese thekson se prej vitit 1993 e deri me 1997 prona është shfrytëzuar nga Ndërmarrja Shoqërore mbi bazën e dhënies me qira nga ana e babait të palës ankuese dhe se konstatimet në Vendimin e KKPK-së janë të pasakta sepse ata nuk mund të administrojnë me prona private
11. Në bazë të lartcekurave, pala ankuese kërkon nga Gjykata Supreme që ta anulojë vendimin e KKPK-së dhe ta vërtetojë të drejtën e ri-posedimit në dobi të palës ankuese.

### **Arsyetimi ligjor**

12. Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve ankimore sipas nenit 194 të Ligjit Nr. 03/L-006 mbi procedurën kontestimore (Gaz. Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.38/2008) (në tekstin e mëtejshëm LPK), Gjykata gjeti se ankesa është e pranueshme dhe e

afatëshme sipas nenit 186 par. 1 lidhur me nenin 196 të LPK-së. Kjo për arsye se pala ankuese vendimin e Komisionit e ka pranuar më 18 Shkurt 2015, ndërkaq ankesë ka paraqitur më datë 6 Mars 2015. Nga kjo mund të konstatohet se ankesën e ka paraqitur në afatit prej 30 ditësh të parashikuar me dispozitën e nenit nenit 12 par. 1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-79. Me këtë dispozitë ligjore parashikohet se “*ankesa kundër vendimit të KPCC mund të ankimohet brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e pranimit*”..

### **Meritat e ankesës**

13. Gjykata Supreme e shqyrtoi Vendimin e ankimuar dhe konstatoi se ankesa është e pabazuar dhe se KKPK-ja ka marrë vendim korrekt kur e hodhi poshtë kërkesën për shkak të mungesës së juridiksionit të saj.
14. Në përputhje me nenin 3.1 të Ligjit nr.03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka ta drejtë nga Komisioni në urdhër për ri-posedim të pronës nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon jo vetëm pronësinë mbi një pronë të paluajtshme private, por edhe se ai ose ajo tani nuk është në gjendje t'i ushtrojë ato të drejta pronësore për shkak të rrethanave që lidhen drejtpërdrejtë apo që rezultojnë nga konflikti i armatosur që ndodhi në Kosovë ndërmjet 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999.
15. Fillimisht, pala ankuese pretendon se ajo e fitoi të drejtën e pronësisë mbi pronën e kërkuar në bazë të Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Lipjan P.Br.541/92 të datës 20 Korrik 1993. Ky aktgjykim ishte verifikuar pozitivisht por Sekretaria Ekzekutive e AKP-së *ex officio* e gjeti Certifikatën për të Drejtat mbi Pronën e Paluajtshme që i pasqyron pronat e kërkuara të regjistruara në emër të ndërmarrjes Bujqësore të Vrellës dhe se ngastra amë ishte ndarë në ngastra më të vogla dhe se i ishte nënshtruar privatizimit përmes autoritetit ligjor për Privatizim dhe ishte në një pjesë e shfrytëzuar nga Aeroporti ndërkombëtar i Prishtinës.
16. Në përputhje me nenin 20 të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore (Gazeta Zyrtare nr.6/80), në fuqi në kohën kur është nxjerr aktgjykimi, e drejta e pronësisë fitohet sipas vetë ligjit, në bazë të veprimit juridik (transferim juridik) dhe me trashëgim.
17. Megjithatë, neni 33 i Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore (GZ RSFJ, Nr.6/80), përcakton se në bazë të veprimit juridik e drejta e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme fitohet me regjistrimin në regjistrat publik ose në mënyrën tjetër përkatëse të

caktuar me ligj. Edhe Ligji aktual nr. 03/L-154 Për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore në nenin 36 pika 1 parasheh se “Për bartjen e pronësisë në paluajtshmeri është e nevojshme një punë juridike e vlefshme ndërmjet tjetërsuarit dhe fituesit si bazë juridike dhe regjistrimi i ndryshimit i pronësisë në Regjistrin e të drejtave në paluajtshmeri

18. Kjo çon në konkludimin se familja e palës ankuese nuk e ka fituar të drejtën pronësore pasi që nuk janë plotësuar kushtet e neneve 20 dhe 33 të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore (GZ RSFJ, Nr.6/80).
19. Prona e kërkuar ka qenë dhe ende është e regjistruar në emër të ndërmarrjes “Kooperativa Bujqesore “Kosova” e Vrellës së Lipjanit, që do të thotë se ka qenë dhe është pronë shoqërore. Shenimet e gjetura nga Sekretaria Ekzekutive konfirmonin se prona ende trajtohej si pronë shoqërore dhe si e tillë ishte nënshtruar procesit të privatizimit e për këtë edhe juridiksioni bie ekskluzivisht me Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës sipas nenit 4.1 (c) dhe nenit 5.1 (a) të Rregullores së UNMIK-ut për Dhomën e Posaçme 2008/4 e amendamentuar me ligjin nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe ndryshim dhe plotësimet e këtij Ligji.
20. Sipas legjislacionit në fuqi mbrojtja e të drejtave pronësore mbi pronat shoqërore dhe/ose pronave shtetërore nuk është në juridiksionin e KKPK-së, respektivisht të Kolegjit të Apelit të AKP-së.
21. Në bazë të gjitha pikave të lartcekura, Gjykata Supreme konstaton se KKPK-ja pala ankuese nuk e kishte humbur posedimin mbi pronën e kërkuar për shkak të konfliktit të viteve, por si pasojë e përfshirjes në një proces të privatizimit nga ana e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit-tani të Privatizimit.
22. Gjykata Supreme konstaton nuk ka pasur shkelje të së drejtës materiale apo vërtetim të mangët të fakteve. Zyrtarët e kadastrit e kishin pohuar se si rezultat i privatizimit ishin bere ndryshime ne regjistra dhe prona ishte ndare ne parcela dhe regjistruar në emër te personave tjerë.
23. Ky aktgjykim nuk paragjykon ndonjë të drejtë pronësore për poseduesit aktual e as që paraqet pengesë për palët për inicim të procedurës pranë organit kompetent apo gjykatës kompetente nëse e gjejnë me interes ligjor
24. Në bazë të lartcekurave dhe në përputhje me nenin 13.3 nën (c) të Ligjit 03/L-079, është vendosur sikurse në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

**Këshillë ligjore**

Në përputhje me nenin 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky Aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

*Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit*

*Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it*

*Ragip Namani, Gjyqtar*

*Bjorn Olof Brautigam, Referent i EULEX-it*